



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 54-të, të mbajtur më 02.11.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Kërkesa e paraqitur sipas numrit 12-1433/1 të 05.04.2021. Refuzohet.

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprimin kompetent, sepse nuk ka pohime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtar gjatë ushtrimit të autorizimeve publike dhe detyrës zyrtare.

Lënda me numër 12-1433/1 të datës 05.04.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb-faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më 05.04.2021 një kërkesë u dorëzua nga një parashtrues i panjohur dhe është formuar lënda me numër 12-1433/1 të 05.04.2021

Në denoncim, e cila është dorëzuar me shkrim dore dhe është e vështirë për t'u lexuar, kërkon që KSHPK-ja të fillojë procedurat kundër personave fizikë dhe juridikë. Përndryshe, thuhet që menjëherë të iniciojë procedurë kundër: kompani ndërtimi ----- Shkup; ----- i cili dyshohet se ka vjedhur aksione nga monopoli -----; ----- biznesmen nga -----; gjyqtari ----- dhe bashkëshorti i saj që kreu një vepër të rëndë penale.

Pas shqyrtimit të pohimeve në fjalë, KSHPK konstaton se denoncimi nuk përmban pohime apo indikacione të qarta për veprime të kundërligjshme apo të palejueshme të personave zyrtar në ushtrimin e autoritetit publik dhe detyrës zyrtare, për të cilat ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetentë.

Nga sa u tha më lartë, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Pёrgatiti: B.K.SH

Miratoi: K.N, anёtar i KSHPK - sё

**KOMISIONI SHТЕТЌОРОР
PЉР PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETAR
Biljana Ivanovska**

